



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 52 datë 06.07.2016

Për

“Një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016(i ndryshuar)”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, pika 1/1.3, shkronja “c”, nenit 25, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 113, të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 39, paragrafi i fundit dhe nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja “a” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 8, pika 2,17, pika 4 dhe nenit 36, pika 2 të ligjit nr. Nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”; udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(i ndryshuar); udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58 datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar); si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”(i ndryshuar) si më poshtë:
 - a- Shpërndarjen e Financimit për projekte të reja nga FZHR për vitin 2016 në programin “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale” në shumën 773,980,288 lekë, në programin e Arsimit në shumën 31,997,060 lekë sipas tabelës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b- Rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik për vitin 2016, sipas tabelës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c- Rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit për vitin 2016, sipas tabelës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në zbatim të pikës 1-a, të miratojë detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve për objektet e reja të vitit 2016 të FZHR-së nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, në programet e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik dhe Arsimit Parauniversitar, sipas pasqyrave nr. 2 dhe nr. 3 pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Të miratojë një shtesë në buxhetin e Klubit Sportiv “Tirana” për mbështetje të Ekipit të Peshëngritjes, për pjesëmarrjen në lojërat Olimpike 2016, sipas tabelës nr.4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojë një ndryshim në emërtimin e objektit nga “Rikualifikim urban i rrugëve në bllokun e pallateve "Selitë", nj. administrative nr.5 “ në “Rikualifikim urban i rrugëve në bllokun e pallateve "Selitë", të kufizuar nga Rr. "Hamdi Pepa", Rr. "Ilia Dilo Sheperi", Rr."Visarion Xhuvani" dhe Rr. "Leka i Madh" nj. administrative nr.5 (pjesë e tabelës nr.4.1 dhe 4.3 të VKB nr.26 datë 23.05.2016, fonde të FZHR-së).
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit dhe Klubi Sportiv “Tirana”.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefëktit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

